



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 17 DHJETOR 2010  
NR.REF.: AGJ 75/10

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin nr. KI 08/09**

**Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut - IMK Ferizaj,  
e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj,  
Aktvendimi C. nr. 340/2001, i datës 11 janar 2002**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

në përbërje:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtrues i kërkesës**

1. Parashtrues është Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së tubave të çelikut - IMK nga Ferizaj. Në procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Gjykata), përfaqësohet nga z. Ali Azemi, nga Ferizaj, kryetar i sindikatës me banim në Ferizaj.

#### **Vendimi i sfiduar**

2. Vendimi i sfiduar nga parashtruesi është Aktvendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt, i datës 6 tetor 2008.

## Objekti i çështjes

- Objekti i çështjes i kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së pretenduar të parimit *res judicata* e përcaktuar në Nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Komunale e Ferizajt, e cila, me aktgjykimin e 11 janarit 2002, ka miratuar kërkesën për kompensim të rrogave të papaguara të 572 punonjësve në ndërmarrjen shoqërore Fabrika për prodhimin e tubave të çelikut IMK (në tekstin e mëtutjeshëm: IMK) në shumë prej 25.649.250,00 €. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm (*res judicata*) më 11 mars 2002. Më 22 dhjetor 2005, e njëjta Gjykatë Komunale lejoi përmbarimin e aktgjykimit. Megjithatë, përmbarimi deri më tani nuk është kryer.
- Gjithashtu, parashtruesi pretendon se ka pasur shkelje të Nenit 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit] dhe të së drejtës në kompensim për rrogat e papaguara.

## Baza juridike

- Kërkesa është e bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji) dhe nenet 54 dhe 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja e punës).

## Procedurat para Gjykatës Kushtetuese

- Më 3 mars 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatë.
- Më 26 shkurt 2009, punonjësit e përfaqësuar nga parashtruesi i kërkesës dorëzuan kërkesën për përmbarim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtutjeshëm: Gjykata), duke kërkuar përmbarimin e aktvendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001 të 11 janarit 2002, dhe për të obliguar Fabrikën e tubave të çelikut IMK në Ferizaj, brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i vendimit të Gjykatës, t'i paguaj parashtruesit shumën prej 25.649.250,00 €, me kamatë prej 3% të llogaritur nga 13 marsi 2002, deri në datën e pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.
- Më 3 mars 2009, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa është regjistruar në Gjykatë.
- Më 11 gusht 2009, Gjykata njoftoi IMK-në lidhur me kërkesën e parashtruesit dhe kërkoi nga IMK dorëzimin e përgjigjes përkitazi me kërkesën.
- Me urdhër të Kryetarit nr. GJR. 10/09, më 24 shtator 2009, gjyqtari Altay Suroy është emëruar Gjyqtar raportues.
- Më 1 tetor 2009, Kryetari, me urdhrin Nr. KSH. 08/09, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarit Almiro Rodrigues (kryesues), dhe Kryetarin Enver Hasani dhe gjyqtaren Iliriana Islami.
- Më 12 nëntor 2009, Gjykata i dërgoi shkresë parashtruesit duke kërkuar sqarime në lidhje me të drejtat e shkelura, vendimin konkret që kundërshtohet dhe autorizimin për përfaqësimin e punonjësve. Më 25 nëntor 2009, parashtruesi dorëzoi autorizimin e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj.

13. Më 12 shkurt 2010, Gjykata i dërgoi shkresë Gjykatës Komunale në Ferizaj duke kërkuar informata mbi hapat që janë ndërmarrë nga Gjykata Komunale për përmbartimin e aktvendimit C. nr. 340/2001. Më 12 shkurt 2010, Gjykata i dërgoi shkresë Agjencisë Kosovare të Privatizimit<sup>1</sup> (AKP) duke kërkuar informata nëse AKP ka qenë e përfshirë në rastin e referuar nga parashtruesi dhe në përmbartimin e aktvendimit C. nr. 340/2001. Më 12 shkurt 2010, Gjykata i dërgoi shkresë Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke kërkuar informata lidhur me mjetet juridike që ekzistojnë për përmbartimin e vendimeve.
14. Më 5 mars 2010, Gjykata pranoi përgjigjen nga AKP e cila ofroi një historik të lëndës së punonjësve të IMK-së.
15. Më 11 mars 2010, KGJK, me kërkesë të Gjykatës dërguar më 22 shkurt 2010, për ofrimin e informatave për mospërmbartimin e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj (Aktvendimi C. nr. 340/2001), u përgjigj dhe theksoi se ka pranuar përgjigje nga Gjykata Komunale në Ferizaj më 10 mars 2010, duke nënvizuar se me vendim të Gjykatës Komunale në Ferizaj (Vendimi E. nr. 469/05) më 6 tetor 2008, të gjitha procedurat e përmbartimit janë pezulluar, bazuar në njoftimin e AKM-së së IMK është vënë në likuidim. Më tutje, KGJK theksoi se ky vendim i është dërguar parashtruesit. Më 23 mars 2010, Gjykata i dërgoi parashtruesit përgjigjen e AKP-së dhe të Gjykatës Komunale në Ferizaj për komentim.
16. Më 6 prill 2010, parashtruesi dorëzoi përgjigjen me kërkesë të Gjykatës më 23 mars 2010.
17. Me urdhër të Gjykatës, nr. 08-1-09/10, 21 shtator 2010, u vendos që lidhur me lëndën KI-08/09 të mbahet Seanca dëgjimore.
18. Më 13 tetor 2010, seanca dëgjimore është mbajtur, ku ishin të pranishëm përfaqësuesi i parashtruesit dhe përfaqësuesit e AKP-së dhe NewCo IMK. Gjykata Komunale në Ferizaj, po ashtu, është ftuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore, mirëpo nuk iu përgjigj ftesës. Po këtë ditë, parashtruesi dhe AKP-ja dorëzuan dokumente shtesë.

### **Përmbledhje e fakteve**

19. Më 27 shkurt 1990, menaxhmenti i përkohshëm i ndërmarrjes shoqërore IMK në Ferizaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për masat e përkohshme kolektive, ndërpreu kontratën e punës për 572 punonjësit, me arsye se kishin munguar në punë për pesë ditë të njëpasnjëshme. Punonjësit parashtruan kundërshtim pranë menaxhmentit të përkohshëm të IMK-së, mirëpo nuk kanë pranuar asnjë përgjigje në kundërshtimin e tyre. Më pastaj, ata parashtruan kërkesë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre pranë Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, duke konsideruar se vendimi i kundërshtuar i IMK-së është i paligjshëm, bazuar në atë që gjatë ditëve në fjalë, ata nuk janë lejuar të hyjnë në fabrikë dhe ta vazhdojnë punën.
20. Më 2001, punonjësit parashtruan në Gjykatën Komunale në Ferizaj kërkesëpadi lidhur me shkarkimin e tyre dhe humbjen e pagave nga data e shkarkimit të tyre deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tyre.
21. Më 11 janar 2002, Gjykata Komunale në Ferizaj vlerësoi kërkesëpadi të punonjësve duke pasur parasysh Nenin 8 të Ligjit të procedurës kontestimore dhe mori vendim

<sup>1</sup> Sipas nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AKP-ja është përcaktuar pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

se kërkesëpadia është e bazuar. Më tutje, Gjykata theksoi se vendimi i IMK-së për të ndërprerë kontratat e punës ishte i paligjshëm dhe se punonjësit që ishin raportuar në punë deri më 1 maj 2001, duhet të rikthehen në pozitat e tyre në punë ose në vendet e punës në pajtim me kualifikimet dhe aftësitë e punës dhe duhet t'i realizojnë të gjitha të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës me IMK-në nga 19 shkurti 1990 deri më 1 maj 2001. Gjykata e arsyetoi vendimin me atë që IMK nuk kishte nisur procedura disiplinore kundër punonjësve, siç kërkohej me Ligjin për marrëdhënie të punës dhe rregulloret vartëse të nxjerra nga IMK (Rregullorja e IMK-së për Përgjegjësinë disiplinore dhe materiale), dhe në këto procedura nuk ka dëshmuar se punonjësit kishin munguar në punë për pesë ditë të njëpasnjëshme. Gjykata Komunale më tutje ka konstatuar se punonjësit janë raportuar në punë çdo ditë prej 19 shkurtit deri më 5 maj 1990, mirëpo forcat policore nuk ua kishin lejuar hyrjen. Veç kësaj, asnjë nga punonjësit nuk ka pranuar vendim individual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të Gjykatës Themelore për Punë të Bashkuar lidhur me kërkesën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre - prandaj, deri më tani, çështja nuk ka fituar asnjë vëmendje gjyqësore. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale përfshinte informatën se apeli ndaj tij duhet të parashtrohet pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, brenda tetë ditëve nga pranimi i kopjes së aktgjykimit me shkrim.. Megjithatë, IMK nuk e ka shfrytëzuar këtë mjet juridik. Meqë IMK nuk e ka apeluar aktgjykimin në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, aktgjykimi i Gjykatës Komunale i datës 11 janar 2002 u bë *res iudicata* më 11 mars 2002.

22. Më 20 mars 2002, Bordi ekzekutiv i IMK-së vendosi të aprovojë kërkesën e punonjësve për përmbarrimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe të rikthejë punonjësit në pozitat e tyre në punë në pajtim me aktgjykimin. Bordi ekzekutiv konstatoi se IMK do të ndërmerr veprime për t'i kompensuar punonjësit në pajtim me aktgjykimin dhe, prandaj, nuk ka nevojë të iniciohet asnjë procedurë përmbarrimore para gjykatës. Dega financiare e IMK-së përlloragiti shumën për kompensim të punonjësve. Meqë IMK nuk i zotëronte mjetet financiare për kompensimin e punonjësve në atë kohë, IMK do të merr përgjegjësi për t'i kompensuar punonjësit me anë të mjeteve tjera, siç është lëshimi i letrave me vlerë. Për më tepër, nëse në ndërkohë IMK i nënshtrohet procesit të transformimit të pronësisë dhe IMK-ja nuk i kompenson punonjësit, të njëjtit kanë të drejtë të bëhen aksionarë në ndërmarrje.
23. Më sa duket, meqë ata nuk e kanë realizuar atë që kishte premtuar IMK, punonjësit iu drejtuan edhe një herë Gjykatës Komunale në Ferizaj, duke kërkuar nga gjykata urdhër përmbarrimi të aktgjykimit të po kësaj gjykate të 11 janarit 2002.
24. Më 22 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Ferizaj lejoi përmbarrimin e këtij aktgjykimi të 11 janarit 2002, duke ndaluar kështu privatizimin e IMK-së nga ana e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).
25. Më 16 janar 2006, një gjyqtar i vetëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj mori vendim, sipas detyrës zyrtare, që të lejojë përmbarrimin e vendimit të saj të 22 dhjetorit 2005 ndaj IMK-së, mirëpo për të kthyer prapa pjesën e vendimit ku gjykata kishte ndaluar privatizimin e IMK-së. Gjyqtari e arsyetoi vendimin me atë që, ndonëse Gjykata kishte lejuar tërë përmbarrimin e kërkesëpadsisë së 912 punonjësve për pagesë të rrogave të IMK-së në shumë prej 25.649.250 euro, me kamatë vjetore prej 3%, duke u llogaritur nga 13 marsi 2002 (bazuar në titullin përmbarrimor të aktgjykimit të 11 janarit 2002), është vlerësuar, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës nga gjyqtari, se është gabim në procedurë për lejimin e përmbarrimit, sepse në të njëjtën kohë, gjykata, gabimisht, ka shqiptuar masë të përkohshme të ndalimit të shitjes së IMK-së nga ana e AKM-së për qëllime të privatizimit. Sipas mendimit të gjyqtarit, AKM është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 si

Agjenci e pavarur, që nënkupton se çështjet dhe rastet që kanë të bëjnë me privatizimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve), duhet të përjashtohen nga juridiksioni i gjykatave vendore në pajtim me atë rregullore. Gjyqtari konstatoi se propozimi i kreditorëve (punonjësve) për ta lejuar shqiptimin e masës së përkohshme të ndalimit të shitjes së IMK-së duhej të hidhej poshtë në pajtim me dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore, ndërsa pjesa tjetër e dispozitivit për të lejuar përmbarimin mbetet e pandryshuar.

26. Në mars 2006, kryesuesi i Sindikatës së Pavarur theksoi se, nëse nuk ka masa në dispozicion për t'i kompensuar punonjësit, ata duhet të marrin aksione të pronësisë në IMK.
27. Më 25 mars 2006, punonjësit paraqiten një propozim shtesë në Gjykatën Komunale për përmbarimin e dhunshëm të vendimit të saj të datës 16 janar 2006. Sipas punonjësve, ata, në cilësi të kreditorëve, nuk ishin në gjendje t'i realizojnë kërkesat e tyre financiare, sipas urdhrit të vendimit të Gjykatës Komunale të 16 janarit 2006, për shkak të mungesës së mjeteve në IMK. Ata kanë kërkuar nga Gjykata Komunale që të përcaktojë, bazuar në vendimin e mëhershëm të 16 janarit 2006, përmbarimin në natyrë ndaj IMK-së për pagesën e borxhit dhe pranim-dorëzimin e artikujve të luajtshëm dhe të paluajtshëm të IMK-së për ruajtjen e të drejtave të tyre. Më tutje, punonjësit kanë propozuar që çdo veprim kundër urdhrit të gjykatës nga ana e IMK-së do të nënkuptonte përgjegjësi penale dhe se, nëse IMK nuk do të jetë e suksesshme në realizimin e borxhit, ata, si kreditorë, do të bëheshin bashkëpronarë të IMK-së deri në shumën e dhuruar për ta.
28. Më 25 mars 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, e refuzoi kërkesën e punonjësve për ta ndaluar privatizimin e IMK-së, por e vërtetoi aktvendimin e gjyqtarit të Gjykatës Komunale të 16 janarit 2006, për lejimin e përmbarimit të kërkesës së tyre të plotë në lidhje me rrogat e papaguara dhe ri-punësimin e tyre.
29. Në prill 2006, AKM parashtroi padi në kapacitetin e vet si palë e tretë pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj, duke kërkuar që të shpall vendimin gjyqësor për përmbarim si të papranueshëm.
30. Më 17 maj 2006, Gjykata Komunale në Ferizaj vendosi të shtyjë ekzekutimin dhe t'i lejojë AKM-së, si palë e tretë në procedurë, parashtrimin, brenda 30 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, e një padie tjetër pranë gjykatës kompetente (Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme) për të sfiduar aktvendimin për përmbarim.
31. Më 14 qershor 2006, AKM ka kërkuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj që të shtyjë përmbarimin e përcaktuar me urdhrin gjyqësor të datës 16 janar 2006, deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.
32. Më 2 gusht 2006, AKM parashtroi ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/13, në emër të IMK-së. AKM pretendonte, mes tjerash, se ishte e rëndësishë thelbësore që Dhoma e Posaçme të ishte në dijeni se vendimi i saj mbi zbatimin e ligjit në këtë rast jo vetëm që paraqet vendim me rëndësi për opinionin publik në përgjithësi, por edhe do të paraqesë precedent për mënyrën se si ligji duhet të aplikohet në rast të kërkesave për paga të papaguara, dhe në veçanti, do të paraqesë precedent për komisionet e likuidimit gjatë marrjes së vendimeve për disa mijëra kërkesa të kësaj natyre. Më tej, AKM deklaronte se arsyeja primare përse AKM nuk ishte në gjendje ta privatizojë IMK-në ishte për faktin se, në janar 2002, 912 punëtorë aktualë dhe ish-punëtorë të IMK-së kishin marrë aktgjykime nga Gjykata Komunale e Ferizajt, të datuara më 11 janar 2002, me të cilat



u rikthyen të drejtat e punësimit dhe shpërbleheshin me 25,649,250 €. Sipas AKM-së, punëtorët vareshin nga ky aktgjykim dhe nga Vendimi Ekzekutiv pasues me të cilin njihet e drejta e pronësisë mbi IMK-në dhe asetet e saj, dhe se kjo në anën tjetër po e parandalonte avancimin e privatizimit të suksesshëm të IMK-së.

33. Më 9 gusht 2006, Dhoma e Posaçme e refuzoi ankesën e AKM-së, duke thënë se më 2 gusht 2006, 46 ditë para skadimit të afatit të dhënë nga Gjykata, AKM ka dorëzuar këtë ankesë ndaj para kualifikimit pranë Dhomës së Posaçme dhe ka ofruar argumente të detajuara që ekskluzivisht merreshin me meritat e aktgjykimit të lëshuar në janar 2002. Sipas Dhomës, ishte e qartë se AKM po përpiqej të ankohej ndaj aktgjykimit të vitit 2002. Për më tepër, Gjykata Komunale ishte kompetente për të vendosur mbi padinë e janarit 2002, dhe se ky aktgjykim nuk ishte ankimuar e rrjedhimisht ishte bërë i plotfuqishëm (res judicata). Dhoma e Posaçme më tej theksonte se parimi universal i pranuar nga gjykatat anembanë botës përcakton se, aktgjykimet e plotfuqishme lëshohen nga gjykata që ka juridiksion për të shqyrtuar rastin në mënyrë meritorë; aktgjykimi ishte i plotfuqishëm dhe nuk i vente në dyshim të drejtat e palëve të interesuara pas skadimit të drejtës në ankesë. Sipas Dhomës, ky parim paraqiste një pengesë absolute për çfarëdo veprimi të mëtejshëm që do të mund të iniciohej qoftë pranë gjykatës në fjalë apo pranë gjykatës së apelit. Dhoma e Posaçme më pastaj i referohej Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas Dhomës, kishte trajtuar këtë çështje në mënyrë elokvente në rastin *Stere dhe të tjerët kundër Rumanisë*<sup>2</sup>, nga i cili rast Dhoma citonte pjesën në vijim:

*“Në lidhje me këtë duhet të rikujtojmë se sundimi i ligjit, si një nga parimet fundamentale të një shoqërie demokratike, mund të gjendet në të gjitha nenet e Konventës (shih Broniowski kundër Polonisë [GC], nr. 31443/96, § 147, ECHR 2004-V). Ai para supozon respektimin e parimit të sigurisë ligjore, në veçanti sa i përket vendimeve të plotfuqishme gjyqësore të cilat janë bërë res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishqyrtim të aktgjykimeve të plotfuqishme dhe të zbatueshme me qëllim të kërimit të rishqyrtimit dhe vendosjes së sërishme për rastin (shih për shembull, Sovtransavto Holding kundër Hungarisë, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, dhe Ryabykh kundër Ruisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX). Po të mos ishte kështu, rishqyrtimi i vendimeve të plotfuqishme do të rezultonte me krijimin e një klime të përgjithshme të pasigurisë ligjore, gjë që do të zbehte besimin e opinionit publik në sistemin juridik, e rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit”.*

34. Më 19 shtator 2006, AKM lëshoi një komunikatë për shtyp të titulluar: “Deklarata e AKM-së mbi aktvendimet e Gjykatës Komunale mbi kompensimin e punëtorëve për vitet e 90-ta”, në të cilin thuhej se në rastin e IMK-së, një nga mjetet e propozuara juridike, që do të lejonte përmbarimin kundër asetëve të IMK-së për punëtorët që ishin palë në padi, do të ishte të realizohej likuidimi i IMK-së, rrjedhojë e të cilit veprim do të ishin muaj të pasigurisë dhe zbritja e shumave që secili kreditor do t'i kishte në dispozicion, përfshirë këtu edhe punëtorët. Sipas AKM-së, në mënyrë që të ruhet dhe shtohet vlera e ndërmarrjeve shoqërore (NSH, çfarë është edhe IMK), strategji optimale do të ishte që të njëjtat të privatizohen përmes metodës spin-off, duke i ndarë elementet produktive të NewCo në një entitet diskret, i cili do të mund të kishte kapital të ri, menaxhim të ri, teknologji të re, dhe në të shumtën e rasteve, do të mund të punësonte shumicën apo të gjithë ish-punëtorët. AKM, më tej, pretendonte se efekti i këtyre padive mbi pagat nga e kaluara, kur çiftëzohet me mënyrën juridike që lejon atakimin e asetëve të NSH-së, do të ketë efekt të padëshiruar dhe negativ me të cilin do t'i jepet fund mundësisë për të krijuar një NewCo të qëndrueshme, e cila do të joshte interes tek investitorët e huaj dhe do të sillte kapital të ri në Kosovë. Krejt në fund, sipas AKM-së, Dhoma e Posaçme i ka

<sup>2</sup> Kërkesa Nr. 25632/02, e datës 23 shkurt 2006

shqyrtuar vendimet dhe procedurat e AKM-së dhe do të kishte të drejtë të vendosë që punëtorët do të duhej të kompensoheshin për pagat nga e kaluara, por pyetja që parashtrohej nuk ishte thjeshtë: “nëse punëtorët do duhej kompenzuar”, por “si” do të duhej të kompensohen ata, apo “nga kush”?. Edhe pse AKM i ka kuptuar tërësisht dhe i ka vlerësuar vështirësitë me të cilat janë përballur punëtorët e NSH-ve, të cilët ishin larguar nga vendet e tyre të punës gjatë viteve të 90-ta në mënyrë diskriminuuese, ajo mbronte qëndrimin se, sipas ligjeve të zbatueshme, gjykatat nuk ishin në gjendje t’i japin pronësi mbi një ndërmarrje kreditorëve, dhe se dhënia e të drejtës së pronësisë mbi një NSH për punëtorët përfundimisht do të pengonte rritjen e shpejtë të ekonomisë së Kosovës, dhe do ta shtynte AKM-në që të kryejë likuidime që nuk janë të domosdoshme, të cilat do të rezultonin me humbje neto tek industritë që potencialisht janë produktive. Duke u bazuar në këtë, AKM do të vazhdojë të kursejë dhe të mbrojë vendet e punës, duke realizuar një program të privatizimit që do t’i sjell përfitime tërë Kosovës.

35. Më 2 tetor 2006, punëtorët kërkuan nga Gjykata Komunale në Ferizaj që të refuzojë propozimin për shtyrjen e përmbarimit, duke pretenduar se shtyrja e përmbarimit, që propozohej nga IMK do të shkaktoje dëme të konsiderueshme të riparueshme për ta, dhe se shtyrja do të mund të përcaktohej vetëm me pëlqimin e tyre si kreditorë.
36. Më 11 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Ferizaj i ngriu asetet financiare të IMK-së, duke e obliguar AKM-në që t’ua paguajë punëtorëve shumën prej 25.649.250 € nga asetet e IMK-së. Më 11 dhjetor 2006, një gjyqtar i Gjykatës Komunale në Ferizaj, ia dërgoi një letër AKM-së në të cilën thuhej se për shkak të presionit të vazhdueshëm që punëtorët ushtrojnë mbi të personalisht dhe mbi gjykatën, ai kërkonte nga AKM që të pranojë kërkesën e punëtorëve të IMK-së dhe të trajtojë këtë rast siç i kishte trajtuar në të kaluarën rastet e NSH KD “Tefik Çanga” në Ferizaj, NSH SHAM “Semafori”, etj. në të cilat, punëtorët përkatës, kishin kërkesa të ngjashme financiare me kërkesat e IMK-së dhe në të cilat gjykatat kishin kërkuar nga AKM që t’i realizojë ato kërkesa.
37. Më 13 dhjetor 2006, AKM lëshoi një deklaratë për shtyp ku thuhej se ajo më parë kishte pranuar vetëm një ofertë për NewCo IMK, ndërsa në rundin e parë të tenderimit, të mbajtur në javën paraprake, ishin pranuar dy oferta. Ajo më tej deklaronte se çmimi i ofruar në ofertën e dytë dhe finale të IMK-së ishte 3.657.000 €, me zotim të investimit prej 13.200.000 € dhe punësim të 80 personave.
38. Më 2 prill 2007, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë pranë Dhomës së Posaçme duke kërkuar anulimin e të gjitha procedurave të privatizimit në IMK, dhe duke kërkuar nga AKM lëshimin e urdhërësës për të ndalë procedimin e shitjes së NewCo IMK-së. Me vendimin e 17 dhjetorit 2007, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke deklaruar se nëse parashtruesi i kërkesës do të mund të dëshmonte se kishte pronësi mbi pronën e privatizuar nga AKM, ajo do ta anulonte transaksionin. Megjithatë, në mungesë të një dëshmie të tillë, ajo nuk mund ta bëjë këtë. Për këtë arsye, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte të drejta pronësore, ai nuk kishte bazë për të pretenduar se shitja e IMK-së nga AKM paraqiste shkelje të të drejtave pronësore të tij. Sipas mendimit të Dhomës së Posaçme, gjuha e përdorur në vendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, të datës 25 mars 2006, nuk ngërthen bartje të pronësisë. Në fakt, aty thuhet: “Kreditori...do të hyjë në bashkëpronësi me debitorin deri në masën e kërkesës së kontestuar...në rast se kreditorët nuk arrijnë të realizojnë borxhin me mjete të gatshme...”. Sipas Dhomës, ky dokument thjesht premtonte se në të ardhmen do të lejohej pronësia nëse plotësohen dy kushte: së pari, masa e ndarjes së pronësisë do të përcaktohej në faza të mëvonshme, me fjalë tjera, së pari do duhej të përcaktohej vlera e ndërmarrjes, më

pastaj të kalkuloheshin aksionet e ndara për secilin kreditor, në bazë të kërkesave të tyre, sipas vlerësimit të Gjykatës. Kjo kurrë nuk është bërë, për këtë arsye edhe nuk është bërë bartja; së dyti, kjo do të bëhej vetëm pasi që kreditorët të mos kenë sukses në kthimin e kërkesave të tyre me para të gatshme.. Edhe kjo çështje ishte lënë për t'u zgjidhur më vonë. Dhoma e Posaçme më tej theksonte se parashtruesi i kërkesës kishte bazuar kërkesën e vet në pagat e papaguara pas ndërprerjes jologjore të marrëdhënies së punës, kërkesë kjo që bazohej në aktgjykimin e plotfuqishëm nga viti 2002.

39. Më 8 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës kërkoi rishikim të aktgjykimit pranë Dhomës së Posaçme. Më 13 mars 2008, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën për rishikim (Aktvendimi SCA – 08 – 0021).
40. Më 24 prill 2007, Gjykata Komunale në Ferizaj refuzoi kërkesën e IMK-së, të përfaqësuar nga AKM, për të rihapur procedurën që është përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, të datës 11 janar 2002, bazuar në faktin që kërkesa ishte e pasafatshme.
41. Më 14 qershor 2007, Gjykata Supreme duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori Publik i Shtetit, anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të datës 11 dhjetor 2006, dhe e ktheu rastin për rishqyrtim në atë gjykatë.
42. Më 23 tetor 2007, Gjykata Komunale në Ferizaj rishqyrtoi rastin dhe bllokoi prapë asetet financiare të IMK-së, ndërsa në të njëjtën kohë anuloi të gjitha vendimet e veta të mëparshme për përmbarim.
43. Më 20 nëntor 2007, Policia Speciale uzurpoi IMK-në dhe ua ndaloi punëtorëve vazhdimin e punës.
44. Më 21 nëntor 2007, AKM publikisht deklaroi se IMK është privatizuar në tërësi për shumën prej 3.200.000 € dhe se pronari i ri është zotuar t'i punësojë 360 punëtorë dhe t'i investojë 13.2 milion €.
45. Më 17 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë refuzoi si të pabazuar ankesën e AKM-së kundër vendimit për përmbarim të Gjykatës Komunale, të datës 1 dhjetor 2006.
46. Më 18 dhjetor 2007, Bordi i Drejtorëve i AKM-së e shpalli IMK-në në likuidim në bazë të Nenit 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12<sup>3</sup>. Pas kësaj, punëtorët paraqitën kërkesa e tyre kreditore pranë Komisionit për Likuidime.
47. Më 10 mars 2008, punëtorët i kërkuan Gjykatës Komunale në Ferizaj që të anulojë kontratën e shitjes mes blerësit të IMK-së dhe AKM-së. Ata pretendonin që marrëveshja e shitjes duhet revokuar si e pavlefshme, e paligjshme, e dëmshme, arbitrare dhe në kundërshtim me aktgjykimet e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj të 11 janarit 2002 dhe 16 janarit 2006, vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. Nr. 589/2007, si dhe vendimin përfundimtar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Ata më tutje parashtronin që, kur të paditurit [blerësi dhe AKM-ja] konsideronin që nuk do të mund të arrinin qëllimin e tyre duke shteruar të gjitha mjetet juridike, tani po vinin pengesa të qëllimshme ndaj ekzekutimit të

---

<sup>3</sup> Agjencia mund të iniciojë likuidimin vullnetar të Ndërmarrjeve Shoqërore apo të cilësdo pjesë të tyre, në rast se vlerëson se procedura e tillë është në interes të kreditorëve dhe/ose pronarëve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia do të kryejë likuidimin në bazë të procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Organizata Biznesore, përveç në rastet kur kjo rregullore e përcakton ndryshe.



aktgjykimit të prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, duke kërcënuar edhe me dhunë, kur gjatë natës së 20 nëntorit 2007 dhe me njësitë speciale të policisë, kishin hyrë me forcë në IMK dhe i kishin ndaluar punëtorëve të hynin, me arsyetimin që blerësi kishte blerë IMK-në për 3.200.000 €. Punëtorët përfundimisht kishin deklaruar që blerësi i IMK-së dhe AKM-ja i kishin kërkuar atyre të pranojnë transaksionin si të drejtë dhe e kishin kushtëzuar fillimin e punës me këtë pranim, me të vetmin qëllim që të eliminonin aktgjykimet dhe aktvendimet e prera të organeve më të shenjta të civilizimit modern, pra gjykatave. Ata i kërkuan Gjykatës Komunale që të obligojë të pandehurit të kthenin të drejtën për shfrytëzimin e lirë dhe në paqe të IMK-së tek punëtorët, të cilët kishin punuar në të deri në nxjerrjen e tyre me dhunë nga policia, si dhe të emërojnë një institucion apo një grup ekspertësh që të përcaktojnë vlerën reale të 29 hektarëve tokë, ndërtesave dhe të gjitha pajisjeve industriale dhe mallrave, si dhe mjeteve tjera për funksionimin normal të IMK-së. Ata i propozuan Gjykatës Komunale që të anulojë marrëveshjen mes të pandehurve dhe në shkelje të aktgjykimeve të prera të marra në të gjitha instancat.

48. Më 9 gusht 2008, Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione i Kuvendit të Kosovës iu përgjigj peticionit të punëtorëve të IMK-së të datës 17 mars 2008, duke theksuar që kishte shqyrtuar letrën e punëtorëve të IMK-së, të cilët kishin ushtruar kërkesë-padi për anulimin e kontratës për transaksionin e IMK-së mes një personi nga Ferizaj dhe zyrës së AKM-së në Gjilan. Duke iu referuar Aktgjykimit 469/2005 të Gjykatës Komunale, të vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, të cilat pajtohen që 912 punëtorët duhen kthyer në vendet e tyre të punës, si dhe duke marrë parasysh veprimet kundër ekzekutimit të aktgjykimeve të cilat kanë qenë në favor të punëtorëve, Komisioni vlerësoi që rasti binte brenda mandatit të tij, si dhe kishte theksuar që e vërteton aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, si dhe njëkohësisht, kërkonte ekzekutimin e aktgjykimit të prerë.
49. Më 6 tetor 2008, Gjykata Komunale në Ferizaj ex-officio ndaloi ekzekutimin pas një njoftimi të dërguar nga AKM-ja në Gjykatë, që IMK-ja ishte futur në procesin e likuidimit. Punëtorët nuk ishin ankuar ndaj këtij vendimi, sepse nuk ishin njoftuar për vendimin në fjalë. Ata u njoftuan pas një viti, si dhe pas mbajtjes së disa protestave para Gjykatës Komunale në Ferizaj.
50. Më 29 shtator 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj njoftoi parashtruesin me vendimin e saj të 6 tetorit 2008, për të cilin kishte njoftuar më herët, më 20 tetor 2008. Më 5 mars 2010, Gjykata Komunale në Ferizaj informoi prapë punëtorët me vendimin e saj të 6 tetorit 2008.

### **Ankesat e parashtruesit**

51. Parashtruesi përfaqëson 912 punëtorë, pretendimet e të cilëve kundër punëdhënësit të tyre, IMK në Ferizaj, janë vërtetuar nga gjykatat qysh prej vitit 2002, por ekzekutimi i të cilave deri tani nuk ka ndodhur, duke kryer kështu shkelje të Nenit 49 të Kushtetutës [E drejta për punë]. Parashtruesi më tutje ankohet që aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i datës 11 janar 2002, nuk është ekzekutuar deri sot, duke përbërë kështu shkelje të parimit *res judicata* të përcaktuar me Nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.
52. Kur aktgjykimi i 11 janarit 2002 u bë *res judicata* më 11 mars 2002, punëtorët do të duheshin trajtuar si kreditorë, pasi padia e tyre ishte miratuar. Prej asaj date, punëtorët janë munduar të sigurojnë ekzekutimin e një vendimi *res judicata* deri më sot. Thelbi i kësaj ankese është pra, nëse me ligjin në fuqi, 912 punëtorët kanë pasur mundësi që të marrin ekzekutimin e mirëfilltë të atij vendimi gjyqësor. Në këtë

kuptim, kreditorët kishin fituar disa vendime gjyqësore në instancën e parë dhe në gjykatë apeli në favorin e tyre, duke lejuar ekzekutimin e shumës prej 25.648.259 €, por pa kurrfarë rezultati deri më sot.

53. Parashtruesi i referohet shprehimisht aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 9 gushtit 2006, i cili kishte vërtetuar që Gjykata Komunale në Ferizaj ishte kompetente që të vendosë mbi kërkesë-padinë e janarit 2002, si dhe që aktgjykimi gjegjës, i cili nuk është kundërshtuar asnjëherë, kishte marrë formën e prerë. Parashtruesi i referohet veçanërisht këtij referimi të Dhomës së Posaçme:

“Një parim universal i pranuar nga gjitha gjykatat gjithkund në botë thotë që [pasi] të jetë marrë një aktgjykim i prerë nga gjykata e juridiksionit e cila është kompetente për shqyrtimin e meritave, aktgjykimi është përfundimtar dhe nuk bart dyshime sa i përket të drejtave të palëve të interesuara, pasi të ketë skaduar e drejta e ankesës. Ky parim përfaqëson një pengesë absolute për veprim vijues, i cili do të mund të iniciohej para gjykatës apo gjykatës së apelit. Gjykata Evropiane për të Drejta të njeriut merret me këtë çështje në mënyrën më elokuyente në rastin *Stere dhe tjerët kundër Rumanisë*<sup>4</sup>:

*“Në lidhje me këtë, duhet përkujtuar që sundimi i ligjit, si një prej parimeve më themelore të një shoqërie demokratike është i pandarë në gjithë nenet e Konventës (shih Broniowski kundër Polonisë [GC], nr. 31443/96, § 147, ECHR 2004-V). Ai presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm, thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Ruisë, nr. 52854/99, §52, ECHR 2003-IX). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit ....”.*

54. Në lidhje me arsyetimin e lartpërmendur të Dhomës së Posaçme, parashtruesi pyet pse parimi “që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi të prerë dhe të plotfuqishëm”, nuk është zbatuar në rastin konkret.

## **Dispozitat relevante ligjore në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore**

### **Ligji 2008/03-L008 për Procedurën Përmbartimore**

55. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedurat e ekzekutimit dhe siguria e vendimeve gjyqësore rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 2008/03-L008).

13.1 Aktvendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbartueshëm.

13.2 Aktvendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbartueshëm, e po që se kundër tij nuk është e lejueshme ankesa, ai bëhet edhe i formës së prerë.

13.3 Aktvendimi me të cilin është refuzuar prapësimi bëhet i formës së prerë po qe se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa e paraqitur refuzohet si e pathemeltë.

---

<sup>4</sup> Stere dhe tjerët kundër Rumanisë (parashtresa nr. 25632/02, 23 shkurt 2006).

13.4 Po që se me këtë ligj është paraparë se kundër aktvendimit të shkallës së parë mund të paraqitet ankesa në vend të prapësimit, atëherë aktvendimi i tillë bëhet përmbarimorë, kurse i formës së prerë po që se nuk paraqitet ankesa brenda afatit ligjor, ose kur ankesa e paraqitur refuzohet si e pabazë.

### **Ligji mbi Procedurën e Përmbarimit, RSFJ, PR nr. 692 i 30 marsit 1978**

Neni 3. "Ekzekutimi dhe siguria përcaktohen dhe zbatohen nga gjykata e rregullt".

Neni 9. "Kundër vendimit përfundimtar në procedurat e ekzekutimit dhe sigurimit, revizioni dhe rigjykimi nuk janë të lejueshme".

Neni 27. "Si mënyra të ekzekutimit për të obliguar realizimin e kërkesave pasurore mund të përcaktohen vetëm: shitja e objekteve të luajtshme, shitja e pasurive të paluajtshme, transferimi/konvertimi i kërkesës pasurore në para, konvertimi në para i të drejtave tjera pronësore, respektivisht në mjete materiale apo transferim të mjeteve të cilat mbahen në llogarinë e Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror".

56. Duhet theksuar që në Republikën e Kosovës, edhe pse nuk parashihet me ligj, është praktikë e zakonshme e Gjykatave që të shfrytëzojnë forecat e Policisë së Kosovës për zbatimin me forcë të vendimeve përfundimtare.

### **Vlerësimi i lejueshmërisë dhe meritave të kërkesës**

57. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata vëren që më 11 janar 2002, Gjykata Komunale ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve në bazë të dispozitave relevante të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, si dhe ka vendosur që padia është e bazuar, duke i dhënë të drejtën parashtruesve për shumën prej 25.649.250,00 €, me normë interesi 3% me fillim nga 13 marsi 2002 deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës së ekzekutimit si dhe ri-kthimin në pozitat e mëparshme. Aktgjykimi ka marrë formën *res judicata* më 11 mars 2002. Me vendim të 22 dhjetorit 2005, e njëjta Gjykatë ka lejuar ekzekutimin e këtij aktgjykimi.
58. Megjithatë, deri më sot, që do të thotë gati 9 vjet pas vendimit *res judicata* dhe 5 vjet pas vendimit për ekzekutim, aktgjykimi ende nuk është zbatuar, edhe pse janë mbajtur disa procedura gjyqësore në lidhje me këtë. Për më shumë, ndërkohë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) – që ishte themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të datës 13 qershor 2002, që do të thotë se është themeluar pasi që vendimi i Gjykatës Komunale i datës 11 janar 2002 u bë *res judicata* - ka privatizuar debitorin IMK me "spin off special". Sipas kësaj procedure, të gjitha asetet e debitorit IMK i janë transferuar së pari kompanisë së sapo-themeluar IMK, duke i lënë të gjitha borxhet, duke përfshirë pretendimet e parashtruesve, me IMK-në e vjetër. Vijimisht, NewCo IMK është privatizuar.
59. Rrjedhimisht, edhe për derisa mjetet juridike të disponueshme, sipas ligjit të zbatueshëm, janë shteruar nga punëtorët, këto mjete nuk kanë qenë efektive, në kuptimin që ato nuk i kanë sjellë rezultatet e pritura, sepse punëtorët ende janë duke pritur ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Komunale të datës 11 janar 2002.
60. Kështu, të gjitha përpjekjet e parashtruesve që të ekzekutojnë aktgjykimin e 11 janarit 2002, kanë mbetur të pasuksesshme, tani edhe më shumë në kuptimin që me vendimin e 6 tetorit 2008, e njëjta Gjykatë Komunale e Ferizajt ka suspenduar të gjitha aktivitetet e ekzekutimit. E vetmja mundësi e mbetur për të siguruar të drejtat e tyre që i kanë fituar me aktgjykimin e 11 janarit 2002, ishte që të parashtronin një

kërkesë – si kreditorë të thjeshtë – tek Komisioni i Likuidimit që ishte në krye të likuidimit të debitorit IMK, pas privatizimit të NewCo IMK. Këto procedura janë ende në vazhdim. Kështu, moszbatimi i aktgjykimit të 11 janarit 2002 vazhdon edhe sot.

61. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson që e drejta e inicimit të procedurës gjyqësore në raste civile, siç parashihet me Nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe Nenin 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetet i paefektshëm në dëm të një pale. Do të ishte e pakuptueshme që këto nene t'i përshkruajnë në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në procedurë – procedura që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neneve të lartpërmendura si ekskluzivisht të lidhura me qasjen ndaj gjykatës dhe administrimi dhe efektshmëria e procedurave do të kishte mundësi të çonte në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, *aktgjykimin e ECRtHR-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtrës nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004*).
62. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII*, si dhe *Ryabykh kundër Rosisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX*). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008*; *Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).
63. Për mendimin e Gjykatës, ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenet e lartpërmendura (shih, *mutatis mutandis, Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f. 510, para. 40*). Në rastin konkret, parashtruesit nuk do të duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë res judicata, në favorin e tyre.
64. Duke dështuar, për një periudhë kaq të gjatë kohore në zbatimin e aktgjykimit të 11 janarit 2002, autoritetet e duhura i kanë privuar dispozitave të Nenit 31 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së gjithë efektin e tyre të dobishëm.
65. Rrjedhimisht, Gjykata i referohet Nenit 159.2 të Kushtetutës, që parasheh: "Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës". Kjo mund të kuptohet vetëm në një mënyrë, që do të thotë se Qeveria e Kosovës është e përgjegjshme për të gjitha obligimet lidhur me ndërmarrjet e tilla, duke përfshirë të drejtat e akorduara ndaj parashtruesit përmes vendimit të Gjykatës Komunale të 11 janarit 2002 kundër ndërmarrjes shoqërore IMK.



66. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, garantuar nga nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, është shkelur.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 17 dhjetor 2010, njëzëri

### **VENDOS SI NË VIJIM:**

- I. E SHPALL kërkesën të pranueshme.
- II. KONSIDERON që ka pasur shkelje të Nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të drejtë] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- III. KONSIDERON që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente, në veçanti nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhës ligjor i AKM-së.
- IV. KONSIDERON se, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të dorëzojnë në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtë mujore, informata lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij Aktgjykimi.
- V. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverisë.
- VI. Në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit, ky aktgjykim do të publikohet në Gazetën Zyrtare.
- VII. Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë si dhe mund t'i nënshtrohet korrigjimit redaktues.

**Gjyqtari Raportues**

Altay Suroy, d.v.



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.